



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 168

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 26 nëntor 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Ligj nr. 88/2018 datë 22.11.2018	Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1, të marrëveshjes së huas, të datës 31.12.2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në Hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr. 103/2013.....	11297
Dekret i Presidentit nr. 10973, datë 23.11.2018	Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit.....	11300
Vendim i Kuvendit nr. 119/2018, 22.11.2018	Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar	11300
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 692, datë 21.11.2018	Për lirim nga detyra.....	11300
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 693, datë 21.11.2018	Për caktimin e ditës së premte, datë 30.11.2018, ditë pushimi.....	11301
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 21.11.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 634, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale”, të ndryshuar.....	11301
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 697, datë 21.11.2018	Për një shtesë në vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar.....	11302

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 698, datë 21.11.2018	Për një shtesë në vendimin nr. 269, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”.....	11303
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 699, datë 21.11.2018	Për miratimin e projektit pilot “Për masat për nxitjen e të nxënit, të vijueshmërisë dhe përparimit të nxënësve të shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”, Korçë, për vitin shkollor 2018–2019”.....	11304
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 705, datë 21.11.2018	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Elona Blido.....	11305
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 707, datë 21.11.2018	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Shkodër–Fier.....	11305
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 709, datë 23.11.2018	Për një shtesë fondesh, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2018, dhe rishpërndarje të fondit të pagave për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2018.....	11311
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 710, datë 23.11.2018	Për lejimin e kryerjes së procedurave të zhdoganimit dhe të kontrolleve fizike nga zyrtarët e Zyrës Doganore të Kosovës në Portin e Durrësit dhe Porto-Romano dhe njohjen e licencave të agjencive të përfaqësimit doganor të Kosovës.....	11312



LIGJ
Nr. 88/2018

(Numri i veprimit 43125)

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE NR. 1, TË
MARRËVESHJES SË HUAS, TË DATËS
31.12.2012, NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM (EBRD), PËR FINANCIMIN E
PROJEKTIT TË PËRMIRËSIMIT TË
SIGURISË SË DIGËS NË
HIDROCENTRALIN E KOMANIT,
RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 103/2013**

**MARRËVESHJA NDRYSHUESE NR. 1,
E MARRËVESHJES SË HUAS, E DATËS 31
DHJETOR 2012, NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCAVE DHE
EKONOMISË DHE BANKËS EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE PËR ZHVILLIM
(PROJEKTI I PËRMIRËSIMIT TË SIGURISË
SË DIGËS NË HIDROCENTRALIN E
KOMANIT)**

Datë 28 shtator 2018

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, 84, pika 4, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

Kjo marrëveshje ndryshuese e datës 28 shtator 2018 (Marrëveshja Ndryshuese) është bërë nga dhe ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Huamarrësi) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“BERZH” ose “Banka”).

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Duke pasur parasysh se:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese nr. 1, e marrëveshjes së huas, e datës 31.12.2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në Hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr. 103/2013, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

A. Huamarrësi dhe BERZH-i kanë lidhur një marrëveshje huaje të datës 31 dhjetor 2012 (Marrëveshja Fillestare), në përputhje me të cilën BERZH-i ka rënë dakord t'i japë Huamarrësit një hua që nuk tejkalon 12,700,000 euro, për qëllimet e Projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit (siç përshkruhet në shtojcën 1 të Marrëveshjes Fillestare);

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

B. Huamarrësi, nëpërmjet Njësisë së Projektit, ka zbatuar Projektin, duke arritur kursimet e huas në shumën totale prej 6,128,224 eurosh;

**KRYETARI
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 22.11.2018

C. Në bazë dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese, Huamarrësi dhe BERZH-i dëshirojnë të ndryshojnë Marrëveshjen Fillestare, me qëllim që të zgjerojnë përkufizimin e Projektit, në mënyrë që të përfshijë edhe rehabilitimin e portave të shkarkimit të hidrocentralit të Komanit dhe të sigurojë që kursimet e kredisë të përmendura në pikën B më sipër do të aplikohen për financimin e elementeve të reja të këtij Projekti.

Tashmë, si rrjedhojë, palët e kësaj Marrëveshjeje bien dakord si më poshtë:

Seksioni 1. Përfshirja e termave dhe kushteve standardë

Të gjitha dispozitat e termave dhe kushteve standardë të Bankës, të datës 1 dhjetor 2012, janë përfshirë dhe janë bërë të zbatueshme për këtë Marrëveshje Ndryshuese me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur ato të jenë plotësisht të përcaktuara aty



(dispozitat e tilla në vijim të referuara si “Termat dhe Kushtet Standardë”).

Seksioni 2. Përkufizimet dhe interpretimi:

a) Në këtë Marrëveshje Ndryshuese:

“Datë e hyrjes në fuqi” ka kuptimin e dhënë në seksionin 4 të kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese.

“Marrëveshje Fillestare” ka kuptimin e dhënë në pikën A.

b) Termat e përcaktuar në Marrëveshjen Fillestare (qoftë drejtpërdrejt ose duke iu referuar ndonjë marrëveshjeje ose instrumenti tjetër), përveç nëse përcaktohet ndryshe këtu, kanë të njëjtin kuptim në këtë Marrëveshje Ndryshuese. Dispozitat e seksionit 1.03 (Interpretimi) të Marrëveshjes Fillestare do të kenë efekt siç përcaktohen në këtë Marrëveshje, në tërësi, *mutatis mutandis*.

c) Marrëveshja Fillestare dhe kjo Marrëveshje Ndryshuese duhet të lexohen dhe të interpretohen si një dokument i vetëm.

Seksioni 3. Amendimi:

a) Me efekt në dhe nga data e hyrjes në fuqi, seksionet 1 dhe 2 të përfshira në Marrëveshjen Fillestare fshihen në tërësinë e tyre dhe zëvendësohen përkatësisht me seksionin 1 dhe 2 të kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese.

b) Emërtimet “Ministria e Financave” dhe “ministri i Financave” ndryshohen në “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” dhe “ministri i Financave dhe Ekonomisë” kudo ku përdoren në tekstin e Marrëveshjes Fillestare.

c) Seksioni 2.02 (f) ndryshohet në: “Data e fundit e disponueshmërisë është 31 dhjetor 2021 ose në atë datë të mëvonshme që mund të bihet dakord me shkrim ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit”.

d) Në nenin 6.01, adresa e Huamarrësit ndryshohet si më poshtë:

Për Huamarrësin: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3

Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë

Faks: +355 4 2228 494

e) Dispozitat e Marrëveshjes Fillestare, me përjashtim të dispozitave të ndryshuara nga kjo Marrëveshje Ndryshuese, vazhdojnë të jenë në fuqi dhe me efekt të plotë.

Seksioni 4. Data e hyrjes në fuqi:

a) Data e hyrjes në fuqi do të jetë data në të

cilën BERZH-i i dërgon Huamarrësit një njoftim që konfirmon se kushtet e mëposhtme paraprake janë përmbushur ose hequr dorë sipas diskrecionit të vetëm të BERZH-it, qoftë tërësisht ose pjesërisht dhe nëse u nënshtrohen kushteve ose në mënyrë të pakushtëzuar:

1. BERZH-i do të ketë marrë dy origjinalet e nënshkruara, siç duhet, të secilës prej këtyre Marrëveshjeve Ndryshuese dhe një Marrëveshje Ndryshuese të datës ose rreth datës së kësaj Marrëveshjeje të Projektit (Amendamenti i Marrëveshjes së Projektit);

2. BERZH-i duhet të marrë një njoftim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë që të gjitha procedurat e brendshme ligjore të kërkuara për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese, të jenë plotësuar nga Huamarrësi;

3. BERZH-i do të ketë marrë dëshmi në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për BERZH-in, që ekzekutimi dhe dorëzimi i amendamentit të Marrëveshjes së Projektit në emër të Njësisë së Projektit janë autorizuar ose ratifikuar në mënyrën e duhur nga të gjitha veprimet e nevojshme qeveritare, administrative dhe të korporatës; dhe

4. BERZH-it i janë siguruar dokumente të tjera që mund të ketë kërkuar në mënyrë të arsyeshme.

b) Si pjesë e provave që do të jepen në përputhje me seksionin 4 (a) (3) të kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese, Njësia e Projektit do të japë ose do të mundësojë që BERZH-it t’i jepet një opinion në emër të Njësisë së Projektit nga drejtori i departamentit të tij juridik për çështjet e tilla që lidhen me transaksionet e parashikuara në amendamentin e Marrëveshjes së Projektit dhe që parashikon se amendamenti i Marrëveshjes së Projektit është autorizuar ose ratifikuar, dhe ekzekutuar dhe dorëzuar në emër të Njësisë së Projektit dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjor të Njësisë së Projektit, të zbatueshëm në përputhje me kushtet e tij.

Seksioni 5. Të ndryshme:

a) Të gjitha referencat në “këtë Marrëveshje” ndaj Marrëveshjes Fillestare dhe të gjitha referencat në Marrëveshjen Fillestare ndaj të gjitha instrumenteve dhe marrëveshjeve të lidhura nën të do t’i referohen Marrëveshjes Fillestare të ndryshuar me këtë Marrëveshje Ndryshuese.



b) Kjo Marrëveshje Ndryshuese dhe dokumentet e referuara këtu përbëjnë të gjithë detyrimin e palëve në lidhje me këtë çështje dhe do të zëvendësojnë çdo shprehje të mëparshme të qëllimit ose kuptimit në lidhje me objektin e kësaj çështje.

c) Kjo Marrëveshje Ndryshuese mund të ndryshohet vetëm me një dokument me shkrim të ekzekutuar siç duhet nga palët.

d) Dispozitat e seksionit 6.01 (Njoftimet), të Marrëveshjes Fillestare, janë përfshirë duke iu referuar dhe u bërë një pjesë të kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese, sikur të jenë të paraqitura plotësisht këtu, *mutatis mutandis* dhe (pa cenuar përgjithësinë e saj) sikur referenca në “këtë Marrëveshje” të ishte për këtë Marrëveshjeje Ndryshuese.

Seksioni 6. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Dispozitat e seksionit 8.04 (Zgjidhja e mosmarrëveshjeve) të Termave dhe Kushteve Standardë do të zbatohen, siç përcaktohet këtu në mënyrë të plotë *mutatis mutandis*, duke përfshirë, pa cenuar përgjithësinë e saj, sikur referencat në “Marrëveshjen e Huas” të jenë lexuar si referenca për “këtë Marrëveshje Ndryshuese”. Për shmangien e dyshimit, referencat për “Marrëveshjen e Garancisë” dhe “Marrëveshjen e Projektit” në seksionin 8.04 (Zgjidhja e mosmarrëveshjeve) të Kushteve Standarde nuk do të merren parasysh për qëllimet e këtij seksioni 6.

Në dëshmi të kësaj, palët, e këtu, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje Ndryshuese në katër kopje, në datën e shënuar më sipër.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: _____

Emri: Arben Ahmetaj

Pozicioni: Ministri i Financave dhe Ekonomisë

BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM

Nga: _____

Emri:

Pozicioni:

PROGRAMI 1

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1. Qëllimi i Projektit është që të ndihmojë Huamarrësin në financimin e programit të investimit të Njësisë së Projektit, për: a) Zonën e grykës së digave dhe të pastrimit të digës së hidrocentralit të Komanit; b) Masat e mbrojtjes së shkëmbinjve; dhe c) Rehabilitimin e portave të shkarkimit të hidrocentralit të Komanit, i cili synon forcimin e sigurisë së digave në hidrocentralin e Komanit, Shqipëri.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme, siç mund të ndryshohen nëse bien dakord herë pas here Banka dhe Huamarrësi:

Pjesa A: Përforcimi i zonës së grykës së digës dhe i zonës në depozitimin e majtë;

Pjesa B: Fuqizimi i masave për mbrojtjen nga rënia e shkëmbinjve;

Pjesa C: Rehabilitimi i portave të shkarkimit, të gjitha në hidrocentralin e Komanit, Shqipëri.

Projekti pritet të përfundojë më 31 dhjetor 2021.

PROGRAMI 2

KATEGORITË DHE TËRHEQJET E SHUMAVE

1. Tabela e bashkëlidhur në këtë Program përcakton kategoritë, shumën e huas së alokuar për secilën kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen në secilën kategori.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 më sipër, nuk do të bëhet asnjë tërheqje për shpenzimet e kryera para datës së Marrëveshjes së Huas.

Bashkëlidhja e Programit 2

Kategoria	Shuma e huas, e alokuar në monedhën e kredisë	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen
1. Mallrat dhe punimet për pjesën A	5,619,575 euro	100% e vlerës së kontratës, duke përfshirë çdo taksë
2. Mallrat dhe punimet për pjesën B	825,201 euro	100% e vlerës së kontratës, duke përfshirë çdo taksë



3. Mallrat dhe punimet për pjesën C	6,128,224 euro	100% e mallrave dhe e punimeve për pjesën C, duke përjashtuar taksat
4. Komisioni <i>Front - End</i>	127,000 euro	100%
TOTALI	12,700,000 euro	100%

DEKRET

Nr. 10973, datë 23.11.2018

PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN E PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI MENJËHERË TË LIGJIT

Në mbështetje të nenit 84, pikat 1 dhe 4, dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e ligjit nr. 88/2018, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1, të marrëveshjes së huas, të datës 31.12.2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në Hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr. 103/2013”.

Neni 2

Dhëniën e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 88/2018, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1, marrëveshjes së huas, të datës 31.12.2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në Hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr. 103/2013”.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

**VENDIM
Nr. 119/2018**

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 90/2017, “PËR CAKTIMIN E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 2, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përherhme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

I. Deputeti Fatmir Xhafaj caktohet anëtar në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 22.11.2018

**VENDIM
Nr. 692, datë 21.11.2018**

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Taulant Muka, zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, lirohet nga kjo detyrë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 693, datë 21.11.2018****PËR CAKTIMIN E DITËS SË PREMTE,
DATË 30.11.2018, DITË PUSHIMI**

Në mbështetje të neneve 95, pika 2, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e ditës së premte, datë 30.11.2018, ditë pushimi për punonjësit e administratës shtetërore.

2. Dita e punës, e datës 30.11.2018, do të zëvendësohet në një nga ditët e pushimit brenda këtij viti.

3. Ngarkohen institucionet e administratës shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 696, datë 21.11.2018****PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 634, DATË 1.10.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR
MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR
VLERËSIMIN DHE DHËNIEN ME
KONCESION/PARTNERITET PUBLIK
PRIVAT TË PUNËVE PUBLIKE DHE
SHËRBIMEVE PËR NDËRTIMIN,
OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE
REHABILITIMIN E RRUGËVE
NACIONALE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, pikat 1, shkronja "j", dhe 2, të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në tekstin bashkëlidhur vendimit nr. 634, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, "Rregullat për vlerësimin dhe dhënie

me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale", bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

a) Pika 1, e nenit 14, ndryshohet si më poshtë vijon:

"1. Nëse propozimi i pakërkuar konsiderohet i pranueshëm, autoriteti kontraktor mund të nisë procedurën për dhënie e kontratës nëpërmjet një procesi transparent dhe konkurrues."

b) Neni 15 riformulohet me këtë përmbajtje:

"Neni 15

Dhënia e bonusit

Në rast pranimit të një propozimi të pakërkuar, përpara procedurës konkurruese propozuesi ka të drejtë të përfitojë nga autoriteti kontraktor, i cili vendos për një nga format e mëposhtme të bonusit:

a) Një bonus për rezultatin tekniko-financiar të propozuar prej tij, deri në një maksimum prej 10% (të 100 pikëve në total) të vlerësimit maksimal të garës, që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) Aplikimin e procedurës me publikim të projektit të tij, me qëllim përfitimin e ofertës më të leverdisshme ekonomike, pa ndryshuar projektin teknik."

c) Pas nenit 15 shtohet neni 15/1, si më poshtë vijon:

"Neni 15/1

**Aplikimi i procedurës me publikim të
projektit**

1. Në rastin e aplikimit të procedurës sipas përcaktimit të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 15, më lart, autoriteti kontraktor, pas vendimit për dhënie e kontratës, publikon projektin e propozuesit, me qëllim që të përfitojë ofertën më të leverdisshme ekonomike.

2. Autoriteti kontraktor publikon projektin e propozuesit së bashku me ofertën financiare dhe fton operatorë të tjerë ekonomikë, nëpërmjet një procesi transparent dhe konkurrues të paraqesin propozimet e tyre sipas përcaktimeve në dokumentet e procedurës konkurruese.

3. Oferta më e leverdisshme ekonomike do t'i paraqitet propozuesit me qëllim paraqitjen e një oferte më të leverdisshme ekonomikisht sesa oferta fituese.



4. Nëse propozuesi pranon, atëherë ai shpallet fitues i garës dhe vijohet më tej për negociimin e kontratës.

5. Nëse propozuesi nuk pranon të paraqesë një ofertë ekonomikisht më të leverdisshme, atëherë ofertuesi fitues do t'i paguajë atij vlerën e hartimit të projektit teknik, e cila do të publikohet në dokumentet e procedurës konkurruese.

6. Nëse palët dështojnë në negociimin e kontratës, atëherë ofertuesit do t'i mbahet vlera e garancisë së ofertës dhe do të ftohet propozuesi për negociim sipas vlerës fillestare të propozimit të tij.”.

ç) Në aneksin 1, “Dokumentet standarde të koncesionit/partneritetit publik privat të punëve publike dhe shërbimeve, për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale”, të përmendur në nenin 24, emërtimi i shtojcës 4 riformulohet në “Formulari i ofertës financiare/ekonomike”.

2. Ky vendim nuk zbatohet për propozimet e depozituara pranë Autoritetit Kontraktor, për të cilat është marrë një vendim për leverdisshmërinë e tyre përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 697, datë 21.11.2018

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 903, DATË 21.12.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 112, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 1 e 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie

ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të nenit 2, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit të punës”, të ndryshuar, të nenit 6, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të nenit 12, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, dhe të nenit 32, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 3, të vendimit nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:

“3.1. Përfshihet për vitin akademik 2018-2019, përfitojnë bursa financiare sipas aneksit 1, të këtij vendimi, studentët e regjistruar në vitin e parë dhe në vitet pas të parit, në ciklin e parë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit në fushën e mësuesisë, të përcaktuara në shtojcën 1, të vendimit nr. 216, datë 20.4.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018–2019”.

Studentët e regjistruar në vitin e parë, sipas përcaktimeve të kësaj pike, duhet të përmbushin kriterin e notës mesatare 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), e përlogaritur si mesatare e notave të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë edhe rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore.

Studentët e regjistruar në vitet pas të parit, sipas përcaktimeve të kësaj pike, duhet të përmbushin kriterin e notës mesatare 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë),



e përllogaritur si mesatare e notave të të gjitha detyrimeve të parashikuara për programin përkatës të studimit dhe të shlyera për vitet pararendëse.

Studentët, sipas përcaktimeve të kësaj pike, përfitojnë bursën vetëm për periudhën që ndjekin studimet në këto programe studimi dhe për kohëzgjatjen normale të programit të studimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 698, datë 21.11.2018

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 269, DATË 29.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË INDIVIDËVE QË PLOTËSOJNË KRITERET E PRANIMIT NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE, QË PËRJASHTOHEN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të neneve 1 e 5, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të neneve 2 e 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të neneve 1 e 15, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit të punës”, të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, dhe të neneve 5 e 7, të ligjit nr. 9355,

datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Evropës, “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore””, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1, të vendimit nr. 269, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, pas shkronjës “g” shtohet shkronja “gj”, me këtë përmbajtje:

“gj) Përrjashtimisht për vitin akademik 2018–2019, studentët e regjistruar në vitin e parë dhe në vitet pas të parit, në ciklin e parë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimit në fushën e mësuesisë, të përcaktuara në shtojcën nr. 1, të vendimit nr. 216, datë 20.4.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018–2019”.

Studentët e regjistruar në vitin e parë, sipas përcaktimeve të kësaj shkronje, duhet të përmbushin kriterin e notës mesatare 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), e përllogaritur si mesatare e notave të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë edhe rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore.

Studentët e regjistruar në vitet pas të parit, sipas përcaktimeve të kësaj shkronje, duhet të përmbushin kriterin e notës mesatare 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), e përllogaritur si mesatare e notave të të gjitha detyrimeve të parashikuara për programin përkatës të studimit dhe të shlyera për vitet pararendëse.

Studentët përfitojnë përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit vetëm për periudhën që ndjekin studimet në këto programe studimi dhe për kohëzgjatjen normale të programit të studimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM

Nr. 699, datë 21.11.2018

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT PILOT
“PËR MASAT PËR NXITJEN E TË
NXËNIT, TË VIJUESHMËRISË DHE
PËRPARIMIT TË NXËNËSVE TË
SHKOLLËS 9-VJEÇARE “NAIM
FRASHËRI”, KORÇË, PËR VITIN
SHKOLLOR 2018–2019”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 19 e 28, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e 350 (treqind e pesëdhjetë) bursave/kuotave ushqimore për nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”, Korçë, për vitin shkollor 2018–2019.

2. Vlera e bursës/kuotës ushqimore ditore është 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) lekë në ditë për nxënë, për mbulimin e kostos ushqimore. Vlera e bursës/kuotës ushqimore, që do t’u ofrohet nxënësve në mjediset e shkollës, në formën e shërbimit ushqimor ditor, të paketuar për çdo nxënë, për 170 (njëqind e shtatëdhjetë) ditë mësimore, jepet sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Njësia arsimore vendore të paraqesë pranë njësisë bazë të vetëqeverisjes vendore, Bashkia Korçë, listën emërore të nxënësve që ndjekin

studimet në këtë institucion arsimor, përfitues të bursës/kuotës ushqimore, të detajuar nga klasa e parë deri në klasën e nëntë. Një kopje e listës emërore të nxënësve të trajtuar me bursë/kuotë ushqimore dërgohet në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

4. Fondet publike për mbulimin e shpenzimeve për bursat/kuota ushqimore rishpërndahen nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për Bashkinë Korçë dhe administrohen nga kjo Bashki.

5. Njësia arsimore vendore dhe drejtoria e shkollës “Naim Frashëri”, Korçë, organizojnë aktivitetet ekstrakurrikulare, me qëllim nxitjen e të nxënësve romë dhe egjiptianë të shkollës “Naim Frashëri”, Korçë. Këto aktivitete organizohen në përputhje me udhëzimin nr. 30, datë 12.9.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.

6. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nga buxheti vjetor i miratuar, të mbulojë edhe rimbursimin e Bashkisë Korçë për pagesat e kryera, për programin buxhetor të arsimit 9-vjeçar, për vitin shkollor 2017–2018, në vlerën 3 449 000 (tre milionë e katërqind e dyzet e nëntë mijë) lekë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Korçë dhe njësia arsimore vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

PASQYRA NR. 1

KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E NXËNËSVE (VITI MËSIMOR 2018–2019)

Nr.	Emërtimi	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar/njësi	Vlera ditore/në lekë
1	Bukë	gram	120	341.95	100	12.0
2	Makarona	gram	10.5	37.45	120	1.3
3	Oriz	gram	10.5	38.15	150	1.6
4	Sheqer	gram	14	54.95	100	1.4
5	Fasule	gram	10.5	32.55	150	1.6
6	Perime	gram	45.5	9.45	100	4.6



7	Fruta	gram	35	14.7	100	3.5
8	Vaj	gram	10.5	94.5	180	1.9
9	Gjalpë	gram	7	53.2	531	3.7
10	Mish	gram	31.5	45.5	750	23.6
11	Djathë	gram	8.75	14	400	3.5
12	Reçel	gram	7	32.55	250	1.8
13	Vezë	kokërr	0.35	14.7	12	4.2
14	Qumësht	gram	70	34.3	80	5.6
15	Patate	gram	70	59.5	40	2.8
16	Nënprodukte pule dhe mishi	gram	10.5	35	400	3.2
	Kuota ditore			912.45		76

Shënim. Është e domosdoshme që nxënësi të marrë kuotën ditore në lekë dhe në kalori, ndërsa gramaturat dhe lloji i ushqimit mund të ndryshojnë sipas menyre të ndryshme dhe çmimeve që ofrohen nga konkurrenca e prokurimeve dhe ndikimit të faktorëve të tjerë (gramaturat e normës ditore në pasqyrë janë përdorur për efekt planifikimi).

VENDIM

Nr. 705, datë 21.11.2018

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË ZNJ. ELONA BLIDO

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Elona Blido, në masën 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 707, datë 21.11.2018

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR TURIZMIN TË DISA PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, NË VIJËN BREGDETARE SHKODËR-FIER

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 34, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të pronave të paluajtshme shtetërore, në zonat kadastrale që i përkasin vijës bregdetare Shkodër–Fier, sipas shtojcës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, me qëllim përdorimin e tyre për zhvillimin e qëndrueshëm në turizëm.

2. Ministrisë përgjegjëse për turizmin i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronave të paluajtshme, sipas pikës 1 të këtij vendimi, t'i tjetërsojë ose t'ua japë ato në përdorim të tretëve, përveç projekteve të investimit në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

3. Regjistrimi i pasurive të paluajtshme, sipas pikës 1, të këtij vendimi, bëhet në emër të



Republikës së Shqipërisë, në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin.

4. Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të bëjë korrigjimet përkatëse në përshkrimin e veçantë të kartelave të pasurive të paluajtshme.

5. Ngarkohen ministria përgjegjëse për turizmin dhe kryeregjistruesi i Pasurive të

Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA

1. Zona kadastrale 3072, Shkodër (Pulaj)

ZK	Nr. i pasurisë	Vol	Faqja	Lloji	Sipërfaqja në m ² /ha	Pronësia
3072	1067	5	123	arë	89,900	shtet
3072	1068	5	124	pyll	54,400	shtet
3072	1072	5	128	pyll	285,000	shtet
3072	1073	5	129	pyll	114,400	shtet
3072	1075	5	130	kënetë	560,900	shtet
3072	1076	5	131	kënetë	1,624,700	shtet
3072	1077	5	132	kullotë	8,500	shtet
3072	1078	5	133	pyll	83,500	shtet
3072	1079	5	134	kullotë	3,800	shtet
3072	1080	5	135	kënetë	187,600	shtet
3072	1081	5	136	kënetë	101,800	shtet
TOTALI	11 pasuri					

2. Zona kadastrale 3072, Shkodër (Pulaj)

ZK	Nr. i pasurisë	Vol	Faqja	Lloji	Sipërfaqja në m ² /ha	Pronësia
3072	1138	5	236	kullotë	238,600	shtet
3072	1139	5	237	pyll	279,600	shtet
3072	1152	5	238	pyll	17,835	shtet
3072	1154	5	239	pyll	5,300	shtet
TOTALI	4 pasuri					

3. Zona kadastrale 1076, Shkodër (Baks Rrjoll)

ZK	Nr. i pasurisë	Vol	Faqja	Lloji	Sipërfaqja në m ² /ha	Pronësia
1076	137	1	151	kullotë	33,488	shtet
1076	138	1	152	kullotë	41,820	shtet
1076	139	1	153	kullotë	41,904	shtet
1076	144	1	158	kullotë	25,035	shtet
1076	145	1	159	kullotë	23,168	shtet
1076	146/1	1	160	kullotë	17,304	shtet
1076	147/1	1	162	kullotë	17,169	shtet
1076	150/1	1	168	kullotë	15,037	shtet
1076	151/1	1	171	kullotë	25,602	shtet
1076	152	1	172	kullotë	47,355	shtet
1076	153	1	173	kullotë	44,268	shtet
1076	160	1	180	kullotë	18,892	shtet
1076	161	1	181	kullotë	16,996	shtet



1076	162	1	182	kullotë	16,341	shtet
1076	163	1	183	kullotë	82,990	shtet
TOTALI					467,369 m²	

4. Zona kadastrale 1076, Shkodër (Baks Rrjoll, Fusha e Xunkthit)

ZK	Nr. i pasurisë	Vol	Faqja	Lloji	Sipërfaqja në m ² /ha	Pronësia
1076	71/1	1	76	kullotë	18,345	shtet
1076	72/1	1	78	kullotë	14,927	shtet
1076	72/2	1	79	kullotë	138,067	shtet
1076	73/1	1	80	kullotë	8,847	shtet
1076	73/2	1	81	kullotë	102,854	shtet
1076	74/5	3	159	kullotë	53,995	shtet
1076	76/4	3	149	kullotë	51,526	shtet
1076	77/7	3	142	kullotë	44,758	shtet
1076	83/2	3	134	kullotë	25,740	shtet
TOTALI						

5. Zona kadastrale, 1673 Kurbin (Fushë-Kuqe)

ZK	Nr. i pasurisë	Vol	Faqe	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja m ² dhe ha	Pronësia
1673	58/11	2	113	kënetë	1,399,465 m ² ose 139.9 ha	shtet
1673	1965	9	218	kënetë	2,254,410 m ² ose 225.4 ha	shtet
1673	1888	9	106	ranishte	3,247 m ² ose 0.32 ha	shtet
1673	1891	9	109	ranishte	6,163 m ² ose 0.61 ha	shtet
1673	1921	9	142	ranishte	9,122 m ² ose 0.91 ha	shtet
1673	1922	9	143	ranishte	26,509 m ² ose 2.65 ha	shtet
1673	2007	10	10	ranishte	12,368 m ² ose 1.24 ha	shtet
1673	2009	10	12	ranishte	14,367 m ² ose 1.44 ha	shtet
1673	2047	10	81	vend strehim	340 m ² ose 0.034 ha	shtet
1673	1406	10	114	ranishte	1,098 m ² ose 0.1 ha	shtet
1673	2062	10	113	vend strehim	203 m ² ose 0.02 ha	shtet
1673	2063	10	140	ranishte	43,251 m ² ose 4.32 ha	shtet

6. Zona kadastrale 3332, Kurbin (Shellinxë)

ZK	Nr. i pasurisë	Vol	Faqe	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja m ² dhe ha	Pronësia
3332	70/17	2	239	ranishte	176,909 ose 17.6 ha	shtet
3332	109/1	5	137	s'ka shënime	924,769 m ² ose 92.4 ha	Komuna Fushë-Kuqe
3332	109/2	5	138	kullotë	904,471 m ² ose 90.4 ha	Komuna Fushë-Kuqe
3332	109/8	5	143	s'ka shënime	434,374 m ² ose 43.4 ha	shtet
3332	109/9	5	144	s'ka shënime	Pa sipërfaqe	shtet
3332	109/11	5	146	pyll	370,043 m ² ose 37 ha	shtet



3332	109/13	5	148	ranishte	1,403,207 m ² ose 140.32 ha	shtet
3332	109/14	5	149	pyll	1,559,221 ose 155.9 ha	shtet
3332	109/16	5	151	s'ka shënime	Pa sipërfaqe	shtet

7. Zona kadastrale 1204, Durrës (Bizë)

ZK	Nr. i pasurisë	Vol	Faqe	Lloji	Sipërfaqe në m ² ose ha	Pronësia
1204	1	3	20	pf	13,400 m ² ose 1.3 ha	shtet
1204	2	3	19	kullotë	3,300 m ² ose 0.3 ha	shtet
1204	3	3	18	pyll	129,500 m ² ose 12.9 ha	shtet
1204	4/1	3	17	pyll	408,800 m ² ose 40.8 ha	shtet
1204	5	3	15	kullotë	3,900 m ² ose 0.3 ha	shtet
1204	9	3	11	kullotë	3,800 m ² ose 0.3 ha	shtet
1204	10	3	10	kullotë	5,700 m ² ose 0.57 ha	shtet
1204	43	2	229	kullotë	8,500 m ² ose 0.85 ha	shtet
1204	46/2	6	152(1)		390,900 m ² 39.09 ha	shtet
1204	48	4	48	kullotë	4,100 m ² ose 0.41 ha	shtet
1204	50	4	46	pyll	1,900 m ² ose 0.19 ha	shtet
1204	51	4	45	pyll	448,400 m ² ose 44.84 ha	shtet
TOTALI					1,422,200 m ² ose 142.22 ha	

8. Zona kadastrale, 1204 Durrës (Bizë)

ZK	Nr. pasurie	Vol	Faqe	Lloji	Sipërfaqja m ² /ha	Pronësia
1204	12	3	9	pyll	299,400	shtet
1204	16	3	3	kullotë	4,700	shtet
1204	17	3	4	kullotë	4,100	shtet
1204	24	2	247	pyll	208,000	shtet
1204	25	2	246	pyll	2,200	shtet
1204	26	2	247	pyll	569,800	shtet
1204	27	2		pyll	210,700	shtet
TOTALI					1,298,900 ose 129.8 ha	

9. Zona kadastrale, 1204 Durrës (Shetaj)

ZK	Nr. pasurie	Vol	Faqe	Lloji	Sipërfaqja m ² ose ha	Pronësia
3365	27/4	4	103	pyll	135,980 m ²	Komuna Ishëm
3365	27/6	4	104	pyll	14,630 m ²	Komuna Ishëm
TOTALI					150,610 m ² ose 15 ha	

10. Zona kadastrale 3365, Durrës (Shetaj)

ZK	Nr. pasurie	Vol	Faqe	Lloji	Sipërfaqja m ² ose ha	Pronësia
3365	45			pyll	241,300	Komuna Ishëm
3365	72	3	71	pyll	454,957	Komuna Ishëm
3365	82	3	78	pyll	450,800	shtet
3365	89	3	83	pyll	113,600	shtet
3365	280	3	209	pyll	439,100	shtet
TOTALI					1,458,457 m ² ose 145.8 ha	



11. Zona kadastrale 2009, Durrës (Jubë)

ZK	Nr. pasurie	Vol	Faqe	Lloji	Sipërfaqja m ²	Pronësia
2009	4	4	183	pyll	131,300	shtet
2009	6/1	8	51	arë	3,212	shtet
2009	15/2	4	190	pemishte	18,900	shtet
TOTALI					153 412 m ² ose 15.3 ha	

12. Zona kadastrale 1574, Durrës (NB Frutore Durrës)

ZK	Nr. i pasurisë	Vol	Faqe	Lloji	Sipërfaqja	Pronësia
1574	1/1	1	18	shkëmbore	35,500	shtet
1574	3/2	1	21	ullishte	9,000	Depo Armatimeve Detare
1574	4	5	124	ullishte	18,300	shtet
1574	5/11	5	125	ullishte	31,500	shtet
1574	5/39	12	162	arë	38,325	shtet
TOTALI					123,625 m ² ose 12.3 ha	

13. Zona kadastrale 1574, Durrës (NB Frutore Durrës)

ZK	Nr. pas.	Vol	Faqe	Lloji	Sipërfaqe në m ² ose ha	Pronësia
1574	145/7	5	5	ullishte	5,187	shtet
1574	276/6	5	84	ullishte	28,975	shtet
TOTALI					34,162 m ² ose 3.4 ha	

14. Zona kadastrale 2009, Kavajë (Karpen)

ZK	Nr. pasurie	Vol	Faqe	Lloji	Pronësia	Sip. m ²
2009	92/51	12	46	pa frutë	shtet	8,290
2009	93/22	12	4	ranishte		2,080
						10370 m ² ose 1 ha

15. Zona kadastrale 2009, Kavajë (Karpen)

ZK	Nr. pasurie	Vol	Faqe	Lloji	Pronësia	Sip. m ² ose ha
2009	159/4	15	83	pa frutë	shtet	57,566
						57,566 m ² ose 5.75 ha

16. Zona kadastrale 2009, Kavajë (Peqinaj)

ZK	Nr. pasurie	Vol	Faqe	Lloji	Pronësia	Sip. m ² ose ha
2909	1 / 2	3	224	pyll	shtet	120,460
2909	2/48			pemëtore	s'kemi kartelë	29,000
2909	3	1	103	ranishte	shtet	35100
Shuma						184560 m ² ose 18.4 ha

17. Zona kadastrale 2009, Kavajë (Peqinaj)

ZK	Nr. pasurie	Vol	Faqe	Lloji	Pronësia	Sip. m ² ose ha
2909	1 / 1	4	88	pyll	Komuna Synej	553,139
Shuma						553,139 m ² ose 55.3 ha

18. Zona kadastrale 2009, Kavajë (Peqinaj)

ZK	Nr. pasurie	Vol	Faqe	Lloji	Pronësia	Sip. m ² ose ha
2909	104	4	93	P F	Komuna Synaj	7,000
2909	105	4	94	P F	Komuna Synej	24,500
Shuma						31,500 m ² ose 3.15 ha



19. Zona kadastrale 2909, Kavajë (Peqinaj)

ZK	Nr. pasurie	Vol	Faqe	Lloji	Pronësia	Sip. m ² ose ha
2909	106/22	4	70	pyll	Komuna Synej	806,013
Shuma						806013 m ² ose 80.6 ha

20. Zona kadastrale 3774, Kavajë (Vilë Bashtovë)

ZK	Nr. pasurie	Vol	faqe	Lloji	Sip. m ² ose ha	Pronësia
3774	284/1	10	17	ranorë	261,450	shtet
3774	284/5	13	25	ranorë	294,845	shtet
Shuma					556,295 m ² ose 55.6 ha	

21. Zona kadastrale 3774, Kavajë (Vilë Bashtovë)

ZK	Nr. pasurie	Vol	faqe	Lloji	Sip m ² ose ha	Pronësia
3774	275	10	154	pa frytë	690,600 m ²	shtet
3774	276/1	10	9	kullotë	188,180 m ²	shtet
Shuma					878,780 m ² ose 87.87 ha	

22. Zona kadastrale 1492, Divjakë

ZK	Nr. pas.	Vol	Faqe	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja m ² dhe ha	Pronësia
1492	570/4	40	122	pyll	77,875	shtet
1492	1070	40	149	pyll	12,750	shtet
1492	1071	40	150	pyll	66,000	shtet
1492	1073	40	151	pyll	22,500	shtet
1492	1074	40	152	pyll	200,375	shtet
1492	1077	40	155	pyll	88,317	shtet
1492	1078	40	156	pyll	485,230	shtet
1492	1079	40	157	pyll	731,437	shtet
1492	Shuma				1684484 m ² ose 168.4 ha	

23. Zona Kadastrale 2085, Divjakë (Karavasta e Re)

ZK	Nr. i pasurisë	Faqe	Vol	Lloji i pronës/funksioni	Sipërfaqja m ² ose ha	Pronari
2085	1/2	3	105	arë	30,300 m ²	shtet
2085	2/1	3	106	arë	143,067 m ²	shtet
2085	3/1	3	107	arë	150,144 m ²	shtet
2085	6/1	3	111	arë	144,670 m ²	shtet
2085	7/1	3	112	arë	144,000 m ²	shtet
2085	8/1	3	113	arë	93,100 m ²	shtet
2085	9/1	3	114	arë	151,197 m ²	shtet
2085	10/1	3	115	arë	128,450 m ²	shtet
2085	11/1	3	116	arë	134,400 m ²	shtet
2085	12/1	3	117	arë	133,700 m ²	shtet
2085	13/1	3	118	arë	133,700 m ²	shtet
2085	27/1	3	140	arë	96,327 m ²	shtet
2085	26/1	3	139	arë	132,890 m ²	shtet
2085	249/3	06	63	arë	Sip. 1,615,945 m ² ose 161.5 ha	



24. Zona kadastrale 1002, Fier (Adriatik), zonë pa informacion nga ZRPP-ja Fier

ZK	Nr. i pasurisë	Faqe	Vol	Lloji pronës/ funksioni	Sipërfaqja m ² ose ha	Pronari
1002	22/1					shtet
1002	22/2					shtet

25. Zona kadastrale 3358, Fier (Sheq, Marinas)

ZK	Nr. pas.	Vol	Faqe	Lloji i pasurisë	Sip. m ² ose ha	Pronësia
3358	231/15	1	249	arë	76,541	shtet
3358	584	1	84	kullotë	45,302	shtet
3358	569	2	122	ranishte	349,129	shtet
3358	230/6	2	117	arë	81,924	shtet
3358	232	2	85	arë	5,597	shtet
3358	585	9	166	arë	14,617	shtet
3358	579	9	161	pyll	10,959	shtet
3358	572	9	155	pyll	7,896	shtet
3358	285/2	9	145	arë	103,324	shtet
3358	255/16	3	88	arë	12,417	shtet
3358	642	8	113	kënetë	377,106	shtet
3358	624	8	107	arë	12,417	shtet
3358	572	9	155	pyll	7,896	shtet

VENDIM

Nr. 709, datë 23.11.2018

**PËR NJË SHITESË FONDESH, NGA
FONDI REZERVË I BUXHETIT TË
SHTETIT, MIRATUAR PËR VITIN 2018,
DHE RISHPËRNDARJE TË FONDIT TË
PAGAVE PËR DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË TATIMEVE, NË
BUXHETIN E MIRATUAR
PËR VITIN 2018**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 11 e 13, të ligjit nr. 190/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2018, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, i shtohet fondi prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh për financimin e projektit “Implementimi në sistemin tatimor *e-taxation* të ndryshimeve ligjore të paketës fiskale 2019”.

2. Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2018, në zërin “Shpenzime personeli”, i shtohet fondi prej 23 000 000 (njëzet e tre milionë) lekësh për pagesën e punonjësve me kontratë për periudhën nëntor–dhjetor 2018.

3. Efekti financiar prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh, për financimin e projektit “Implementimi në sistemin tatimor *e-taxation* të ndryshimeve ligjore të paketës fiskale 2019”, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2018.

4. Efekti financiar prej 23 000 000 (njëzet e tre milionë) lekësh, për pagesën e punonjësve me kontratë, sipas pikës 2, të këtij vendimi, të përballohet nga zëri “Shpenzime korrente”, i aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, programi “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, miratuar për vitin 2018.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 710, datë 23.11.2018****PËR LEJIMIN E KRYERJES SË
PROCEDURAVE TË ZHDOGANIMIT
DHE TË KONTROLLEVE FIZIKE NGA
ZYRTARËT E ZYRËS DOGANORE TË
KOSOVËS NË PORTIN E DURRËSIT
DHE PORTO-ROMANO DHE NJOHJEN
E LICENCAVE TË AGJENCIVE TË
PËRFAQËSIMIT DOGANOR
TË KOSOVËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24, pika 3, 48, pika 3 dhe 288, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Zyrës Doganore të Republikës së Kosovës të kryejë procedura doganore në Portin e Durrësit dhe Porto-Romano, për zhdoganimin e mallrave që kanë destinacion hedhje në qarkullim të lirë/destinacion final të përdorimit në Republikën e Kosovës. Për këtë qëllim, zyrtarët/oficerët doganorë të doganës së Kosovës kryejnë në Portin e Durrësit dhe Porto-Romano procedurat e kontrollit/ekzaminimit fizik të mallrave.

2. Bazuar në indikatorët dhe analizën e riskut, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në bashkëpunim me Doganën e Kosovës, përgatit listën e mallrave me risk, për të cilat nuk mund të zbatohet procedura e referuar në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Punonjësit doganorë të Doganës Durrës bashkëpunojnë dhe shoqërojnë zyrtarët e Doganës së Kosovës në kryerjen e funksioneve të tyre. Me përfundimin e procedurave të kontrollit nga zyrtarët e Doganës së Kosovës, vijohet me formalitetet doganore shqiptare.

Në rastet kur gjatë kontrolleve të kryera nga personeli zyrtar i Doganës së Kosovës konstatohen mallra të ndaluara apo trafikim i qenieve njerëzore, njoftohen menjëherë organet e policisë dhe ato doganore shqiptare.

Dega e Doganës Durrës u mundëson zyrtarëve të Doganës së Kosovës përdorimin e peshores apo të mjeteve të tjera në administrim të saj, për ushtrimin e detyrave të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

Faqe | 11312

4. Për kryerjen e deklaramit në përputhje me pikën 1, të këtij vendimi, dhe të veprimeve të transitit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë vendosjen e garancisë për borxhin e mundshëm në këtë regjim, njihen licencat e agjencive doganore të Republikës së Kosovës.

Pas dorëzimit zyrtar të listës dhe të kopjeve të licencave nga Dogana e Kosovës, këto agjenci regjistrohen pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave, me qëllim njohjen dhe regjistrimin nga Dogana e Kosovës, dërgon pranë kësaj të fundit listën dhe kopje të licencave të agjencive doganore të Republikës së Shqipërisë.

5. Autoriteti Portual i Durrësit, Ministria e Brendshme apo subjektet e tjera të përfshira sigurojnë lejet e hyrjes për zyrtarët e Doganës së Kosovës, në ambientet e Portit të Durrësit dhe Porto-Romano, sipas listës që dërgohet nga Dogana e Kosovës dhe konfirmuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Zyrtarët e Doganës së Kosovës ushtrojnë funksionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, me uniformë apo me kostume civile me jelek me shenja identifikuese të Doganës së Kosovës. Mjetet e transportit të Doganës së Kosovës lejohet të kenë mbishkrimet dalluese të saj.

6. Autoriteti Portual i Durrësit apo subjektet e përfshira mundësojnë furnizimin me ujë, energji, lejimin e sjelljes së pajisjeve për mobilimin e zyrave dhe gjetjen e hapësirave për zyra dhe të një sheshi për kontroll fizik, ku zyrtarët e Doganës së Kosovës të kenë mundësi të kryejnë funksionin e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

Zyra doganore e Kosovës lidh kontratat përkatëse, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

7. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë